



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Më 1 dhjetor 2023, Trupi Gjykses në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerë* lëshoi një vendim të mëtejshëm mbi kërkesën e Prokurorisë për modifikimin e kushteve të paraburgimit për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, dhe Rexhep Selimin. Vendimi zëvendëson vendimin e përkohshëm të 17 nëntorit.

Në vendimin e vet, Trupi Gjykses konstatoi se duket se tre të akuzuarit u kanë dhënë vizitorëve informacion konfidencial të marrë në kontekstin e procesit gjyqësor, ose që dhënë gjatë dëshmisë së dëshmitarëve të mbrojtur.

Pa bërë konstatime nëse sjellja e pasqyruar në transkriptet e këtyre vizitave përbën vepër penale, gjykatësit theksuan rrezikun e konsiderueshëm që tre të akuzuarit t'u nxjerrjen informacion të privilegjuar palëve të treta të paautorizuara nëse nuk merren masat e duhura.

Rrjedhimisht, Trupi Gjykses urdhëroi Zyrën Administrative që të vendosë një sistem i cili të fokusohet në identifikimin dhe përjashtimin nga vizitat dhe komunikimet me tre të akuzuarit të vetëm atyre personave që mund të përbëjnë kërcënim për integritetin e procesit, ose të cilët përfshihen në sjellje të papajtueshme me rregullat e Njesisë së Paraburgimit.

Konkretisht, vizitat dhe komunikimet me këta tre të akuzuar nga persona të tjerë përveç mbrojtësve të tyre, Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq apo Avokatit të Popullit të DHKS-së, duhet të marrin miratimin paraprak të Administratores, në mënyrë që të merren parasysh të gjitha aspektet relevante juridike, praktike dhe të sigurisë. Ndër masat e tjera, Trupi Gjykses urdhëroi gjithashtu ndryshimin e kushteve të vizitave. Për shembull, secili nga tre të akuzuarit nuk mund të takojë më shumë se një vizitor në një vizitë, me përjashtim të vizitave nga bashkëshortet dhe fëmijët.

Më shumë hollësi mbi masat lidhur me kufizimet e komunikimeve dhe vizitave të tre të akuzuarve gjenden në paragrafët 51-53, 55-60 dhe 62-78 të vendimit në faqen e internetit të DHKS-së. Trupi Gjykses do t'i shqyrtojë masat çdo gjashtë muaj dhe Administratorja do t'i raportojë Trupit Gjykses në lidhje me zbatimin e këtij vendimi çdo dy muaj.

Në dy vendime të tjera në të njëjtën çështje të datës 1 dhjetor, Trupi Gjykses miratoi mocionin e Prokurorisë për pranim në prova të deklaratave me shkrim të tre dëshmitarëve dhe autorizoi që një dëshmitar tjetër të japë dëshmi me videolidhje, për arsye shëndetësore. Më 5 dhjetor, Trupi Gjykses miratoi pjesërisht një kërkesë të Prokurorisë dhe pranoi si prova disa videomateriale, libra, dhe artikuj gazetash.

Në seancat gjyqësore në çështjen *Thaçi dhe të tjerë*, këtë javë deri tani kanë dëshmuar dy dëshmitarë. Të hënën, më 4 dhjetor, Sadik Halitjaha, ish-epror në UÇK, vazhdoi dhënien e dëshmisë. Me përfundimin e

1





dëshmisë së tij, të martën filloi dëshminë dëshmitarja e tridhjetetë e thirrur nga Prokuroria, Sandra Miçëll (Mitchell), zyrtare e OSBE-së që ka punuar më parë në Kosovë.

Seancat gjyqësore në këtë çështje do të zhvillohen javën e ardhshme nga e hëna deri të mërkurën.

Paneli i Gjykatës së Apelit ka caktuar datën për shqiptimin e Aktgjykimit të Apelit në çështjen *Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës*, për të enjten e ardhshme, 14 dhjetor, në orën 09:30.

Seanca do të jetë publike dhe mund të përcillet në gjuhët shqipe, serbe ose angleze përmes rubrikës së transmetimit në faqen e internetit të DHSK-së (<https://www.scp-ks.org/sq/transmetim>) me një vonesë prej 10 minutash, ose nga galeria për publikun në ndërtesën e Gjykatës.

Për përcjelljen e kësaj seance nga galeria për publikun e Dhomave të Specializuara të Kosovës kërkohet regjistrim paraprak.

Pas shqiptimit të Aktgjykimit të Apelit më 14 dhjetor, do të mbahet informimi i rregullt javor për median në orën 14:30. Gazetarët mund ta ndjekin atë në sallën e informimit të medias, ose përmes programit *Zoom*.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

